UDHËZIM
Nr.308, datë 8.5.2009

PËR PAJISJEN ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË SHTETASVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 "Për ratifikimin e "Kontratës konsensionare "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike" ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Scurite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve",

UDHËZOJ:

1. Shtetasit aplikojnë për pasaportë biometrike në mjediset e përcaktuara nga koncesionari për këtë qëllim dhe në përputhje me rregullat e miratuara në kontratën koncesionare midis Ministrisë së Brendshme dhe Koncesionarit.

2. Dokumentacioni shkresor ruhet nga koncesionari në arkivë për një periudhë pesëvjeçare pas prodhimit të pasaportës.

3. Aplikimi i shtetasve nën moshën 16 vjeç për pasaportën biometrike bëhet vetëm në prezencë të të paktën të njërit prej prindërve, të kujdestarit ligjor ose të përfaqësuesit me prokurë të posaçme.

4. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile nuk ka fuqi vendimmarrëse në procesin e aplikimit, por kryen vetëm verifikimin e identitetit të aplikuesit, duke e konfirmuar në formularin e aplikimit.

5. Shtetasit nën moshën 16 vjeç pajisen me pasaportë biometrike si më poshtë:

a) 0 vjeç deri 6 vjeç, do të pajisen me pasaportë biometrike pa u marrë shenjat e gishtave.

b) 6 vjeç deri 16 vjeç, gjatë aplikimit për pasaportë biometrike do t'u merren, përveç të tjerave, edhe shenjat e gishtave.

6. Pajisja me pasaportë biometrike bëhet brenda 15 ditëve nga data e aplikimit.

7. Pasaporta biometrike do të tërhiqet pranë drejtorive/komisariateve të policisë, sipas procedurës së miratuar.

8. Tërheqja e pasaportës kryhet nga aplikanti, përfaqësuesit e përcaktuar në pikën 2 ose një pjesëtar i afërt i familjes (bashkëshorti/ja, prindi, fëmija).

9. Vlefshmëria e pasaportës për shtetasit nën moshën 16 vjeç është 5 vjet.

10. Shtetasit që kanë aplikuar për pasaportë biometrike, në momentin e marrjes në dorëzim të kësaj pasaporte, vihen në dijeni për pavlefshmërinë e pasaportës së mëparshme, veprim i cili kryhet menjëherë nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit pranë DPPSH.

11. Në rastet kur shtetasit disponojnë viza të vlefshme në pasaportat ekzistuese, ata paraqesin para organeve të kufirit pasaportën biometrike të shoqëruar me pasaportën ekzistuese, në të cilën ndodhet viza e vlefshme. Pasaporta e vjetër evidentohet dhe shënohet, duke ia dorëzuar shtetasit për përdorim deri në përfundim të vlefshmërisë së vizës.

12. Pas lëshimit të pasaportave biometrike, sistemi i kontrollit të kufirit (TIMS) do të kryejë procedurat si vijon:

a) Transferimi i të dhënave do të kryhet manualisht, periodikisht deri në momentin kur të dy sistemet do të mund të komunikojnë online.

b) Kompania koncesionare dërgon periodikisht në rrugë manuale/elektronike/online, informacion mbi pasaportat e lëshuara. Ky grup pasaportash do të krahasohet me pasaportat aktive në sistemin TIMS; të gjitha krahasimet pozitive çaktivizojnë pasaportat ekzistuese në sistemin TIMS.

13. Në çdo ras, kur shtetasi kërkon të ripajiset me pasaportë, do të zbatohen të njëjtat procedura si për marrjen e saj për herë të parë, por duke lëshuar nga ana e aplikantit një deklaratë për arsyet e kërkesës për ripajisje.

a) Shtetasi kërkon të ripajiset me pasaportë përpara mbarimit të afatit të pasaportës që disponon në rastet e mëposhtme:

- kur pasaporta e mëparshme është vjedhur ose dëmtuar;
- kur pasaporta e mëparshme ka humbur;
- kur ndryshojnë gjenealitetet.

14. Në rast të shkeljeve të procedurave të parashikuara në këtë udhëzim, ndaj nëpunësve të ngarkuar me zbatimin e këtij akti do të merren masa disiplinore.

15. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen zyrat e gjendjes civile në bashi/komuna/njësi bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

16. Dispozitat e udhëzimit nr.1627, datë 22.1.2002 "Mbi procedurat për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", të ndryshuar, që bien ndesh me këtë udhëzim, revokohen për të gjitha zyrat ku ka filluar aplikimi për pajisjen me pasaporta biometrike.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe gjen zbatim në të gjitha zyrat që do të fillojnë aplikimin, si dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINNISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani